



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 23/11/2012
Nr. 0201/1182

PËR: Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
Habib Mustafa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, NR. PROTOKOLLI 297/12 DHE NR. 296/12, të pranuar me datë, 05/11/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 05.11.2012 ka pranuar një kërkesë nga z. Refik Ramaj, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, për vlerësim të ligjshmërisë së dy vendimeve të miratuara nga K. K të Vushtrrisë me datë 30.10.2012, në lidhje me Vendimin për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Vendimin për Lirimin nga Pagesa për Shfrytëzimin e Palestrës për të Gjitha Klubet Sportive dhe Shoqatat e Dala nga Lufta.

MAPL, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit në fjalë të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, **KONSTATON** se:


- Në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 për Themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, Vendimi me Nr. të protokollit; 297/12 për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nuk parasheh përfaqësuesin e medieve lokale, por në vend të kësaj pozite parasheh zëdhënësin e Komunës. Prandaj, në bazë të nenit 15 të Rregullores Nr. 03/2011 për Komunikimin Qeveritar me Publikun, Zëdhënësi i Komunës dhe struktura organizative përgjegjëse për komunikim me publikun në institucionet komunale, nuk përfaqësojnë media lokale, por krijojnë dhe mirëmbajtjen marrëdhëniet me media dhe përgatitjen e raporteve të rregullta lidhur me mbulesën mediale.

Prandaj, vlerësojmë se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë duhet të rishqyrtoj vendimin, duke u bazuar në të procedurat e parapara ligjore.

MAPL, kërkon nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrin veprime konkrete, që Vendimit e lartcekura të harmonizohen me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të akteve dhe të njoftojë Ministrinë për hapat e ndërmarrë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së;
Refik Ramaj, shef i GP të LDK-së në K. K së Vushtrrisë
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 23/11/2012
br. 0201/1182

Za: Bajram Mulaku, Gradonačelnik Opštine Vučitrn
Habib Mustafa, Predsedavajući Skupštine Opštine Vučitrn

PREDMET: ZAHTEV ZA RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKA OPŠTINE VUČITRIN , BR. PROTOKOLA 297/12 I BR. 296/12, primljeno dana , 05/11/2012

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je dana 05.11.2012 primilo jedan zahtev od g. Refik Ramaj, šef Parlamentarn grupe LDK-u Skupštini Opštine Vučitrn, za dopunu zakonitosti dve odluke usvojene od SO Vučitrn ,dana 30.10.2012, u vezi sa Odlukom za osnivanje opštinskog saveta za bezbednost u zajednici i Odluku o oslobadjanju od plaćanja za korišćenje sale za sve sportske klubove i ratnih udruženja .

MALS u skladu sa svojim mandator odredjenim po Zakonu zalokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posla razmatranja zakonitosti nevedene Odluke Skupštine Opštine Vučitrn, **KONSTATUJE:**

- Na osnovu člana 4 Administrativnog Uputstva br. 27/2012 o osnivanju opštinskih saveta za bezbednost u zajednici , Odluka sa br. protokola; 297/12 o osnivanju opštinskog saveta za bezbednost u zajednici, ne predvidja predstavnika lokalnih medija, ali na mestu tog položaja predvidja glasnogovornika Opštine. S toga na osnovu člana 15 Uredbe br. 03/2011 za Vladino Komuniciranje sa javnošću , glasnogovornik opštine i odgovorna organizaciona struktura za komuniciranje sa javnošću u opštinskim institucijama, ne predstavljaju lokalne medije , samo stvaraju i održavaju odnose sa medijima i pripremaju redovne izveštaje u vezi sa medijskim pokrićem.

Zato cenimo da, Skupština Opštine Vučitrn treba ponovo da razmotri odluku za osnivanje opštinskog saveta za bezbednost u zajednici, na osnovu predvidjenih zakonskih procedura.

MALS, traži od Predsedavjućeg i Skupština Opštine i Gradonačelnika Opštine Vučitrn da preduzmu konkretne mere, da gore nevedene Odluke budu uskladjene sa zakonskim dispozicijama na snazi , u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje i da obavesti Ministarstvo o preduzetim merama.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,



Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a;*
Refik Ramaj, šef PG LDK- u SO Vučitrn
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a.